

Në bazë të nenit 103 paragrafi (1) pika 2, nenit 135 paragrafi (3), neneve 149, 150 dhe 151 të Ligjit për Arsimin e Lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/2018) dhe Vendimit me numër 02-742/1 të datës 19.04.2022 të sjellur nga Drejtoria Rektoriale e Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, lidhur me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për dhënie të pëlqimit për konkurset për regjistrimin e studimeve të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë në përbërje të Universitetit "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup, Universiteti "Shën Klimenti i Ohrit"- Manastir, Universiteti i Tetovës, Universiteti "Goce Dellçev" në Shtip, Universiteti i Shkencave Informatike dhe Teknologjive "Shën Apostull Pavle" në Ohër dhe Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup në vitin akademik 2022/2023 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr.139/2022), Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup shpall

**K O N K U R S**  
**për regjistrimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve në programet studimore në**  
**Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup në vitin akademik 2022/2023**

**I. Numri i studentëve**

Në fakultetet e Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup në ciklin e dytë të studimeve në vitin akademik 2022/2023 do të mund të regjistrohet numri i studentëve si në vijim:

<b>PROGRAMET STUDIMORE</b>	<b>Numri i studentëve</b>	<b>Kohëzgjatja në semestra</b>	<b>Pagesa e studimit për semestër (në euro)</b>
<b>FAKULTETET</b>			
<b>FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS</b>	35		
Arkitekturë dhe dizajn	25	4	400
Ndërtimtari - konstruktive	10	4	400
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE INFORMATIKE</b>	80		
Inxhinieri softuerike e aplikuar	20	2	400
Inxhinieri softuerike e aplikuar	20	4	400
Matematikë-informatikë për mësimdhënie	20	2	400
Matematikë-informatikë për mësimdhënie	20	4	400
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE</b>	105		
Inxhinieri ekonomike dhe menaxhment	25	2	400
Inxhinieri e transportit dhe komunikacionit	15	2	400
Inxhinieri e transportit dhe komunikacionit	15	4	400
Siguria në punë	20	2	400
Automatikë	15	2	400
Automatikë	15	4	400
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNOLOGJIKE</b>	60		
Inxhinieria kimike	15	2	400
Teknologjitë ushqimore	15	2	400
Nutricionizmi dhe dietetika	15	2	400
Tekstil dizajn dhe modelimi	15	2	400
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE</b>	120		
Punë sociale	15	2	400
Politikë sociale	15	2	400
Media dhe komunikim ndërkulturor	15	2	400
Sport dhe Shkencat e Sportit	15	2	400

Studime Politike dhe Ndërkombëtare	15	2	400
Studime Politike dhe Ndërkombëtare	15	4	400
Politikat publike dhe menaxhimi	15	2	400
Studime Ballkanike dhe Euroaziatike	15	2	400
Program i përbashkët studimor (Joint degree) në FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE me Universitetin e Sasarit në Itali / Joint degree study study program in Faculty of Social Sciences with The UNIVERSITY OF SASSARI in Italy	15	4	
Menaxhimi i Migrimit / Migration Management	15	4	400
Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup	415		

**SHËNIM: Institucioni i Arsimit të Lartë sjell Vendim për numrin minimal të studentëve të regjistruar me qëllim që të fillojë me punë programi studimor. Nëse programi studimor, nuk fillon me punë, kandidatët përkatës do të mund të regjistrohen në programe tjera studimore.**

**Mësimi do të zhvillohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën maqedonase, në përputhje me numrin e kandidatëve të paraqitur.**

Pagesa e studimeve në ciklin e dytë është tërësisht në ngarkesë të studentit dhe ajo është 400 euro (në kundërvlerë të denarit) për çdo semestër, si dhe për mbrojtjen e temës së magjistraturës studentët paguajnë shumë prej 400 eurosh (në kundërvlerë të denarit), dhjetë ditë para ditës së mbrojtjes.

Pagesat të cilat studentët i paguajnë për arsim dhe shërbimet administrative të Universitetit bazohen në vendimin për lartësinë e pagesave të cilat i paguajnë studentët për arsim dhe shërbime administrative të Universitetit.

Në programet studimore mund të regjistrohen kandidatë të cilët kanë të kryer studime përkatëse ose të ngjashme të ciklit të parë sipas programeve dhe planeve studimore paraprake dhe kandidatë të cilët kanë të kryer studime përkatëse ose të ngjashme të ciklit të parë sipas SETK. Për studentët e programeve studimore të ngjashme Këshilli Mësimor Shkencor i njësisë mund të përcaktojë kushte shtesë për regjistrim – provime diferenciale, në përputhje me njohuritë e nevojshme për atë program studimor.

## II. Të drejtë konkurimi

Të drejtë konkurimi kanë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e përgjithshme si në vijim:

- të kenë të kryer ciklin e parë të studimeve në studimet përkatëse ose të ngjashme
- të plotësojnë kushte tjera të parashikuara me programet studimore për organizimin e ciklit të dytë të studimeve të fakultetit përkatës.

## III. Realizimi i konkursit

Procedurën për regjistrimin e kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve universitare (akademike) e realizon Komisioni Universitar i konkursit.

Rangimin e kandidatëve e realizon Komisioni i konkursit i çdo fakulteti të Universitetit. Anëtarët e Komisionit të konkursit i emëron Këshilli Mësimor Shkencor i fakultetit me vendim të veçantë. Ranglista publikohet në tabelën e shpalljeve të Universitetit dhe të fakultetit, si dhe në uebfaqen e Universitetit.

Pas shpalljes së rang listës preliminare të kandidatëve për regjistrim nga Komisioni për Konkurs i njësisë, kandidati ka të drejtë për kundërshtim në afat prej 24 orësh. Në të kundërtën, e humb të drejtën për kundërshtim në procedurën e mëtejme sa u përket rezultateteve të shpallura. Kundërshtimi ka të bëjë vetëm me lëshimet teknike - gabime të bëra gjatë llogaritjes së pikëve, dhe i njejt i drejtohet deri te Komisioni për konkurs i njësisë. Komisioni për konkurs i njësisë sjell Vendim pas kundërshtimit. Vendimet pas kundërshtimit shpallen tek fakultetet. Nëse kandidati nuk është i kënaqur edhe me atë Vendim, në afat prej 12 orëve ka të drejtë ankese deri te Komisionit Universitar për konkursin.

Komisioni Universitar i konkursit në afat prej 24 orëve sjell Vendim ndaj ankesës.

Vendimi i Komisionit Universitar të Konkursit është përfundimtar.

Pas skadimit të afateve për parashtrimin e kundërshtimeve dhe ankesave dhe pas zgjidhjes së tyre, Komisioni universitar i Konkursit shpall rang listën përfundimtare, në bazë të të cilave kryhet regjistrimi i studentëve. Kandidatët të cilët në afatin kohor të paraparë për regjistrim nuk do të bëjnë regjistrim, respektivisht nuk do të dorëzojnë dokumentacionin e duhur për regjistrim në shërbimet studentore të fakultetit përkatës, do të konsiderohet se kanë hequr dorë nga pranimi dhe vendi i tyre do të shpallet përsëri në Konkursin plotësues.

Kandidati e arrin të drejtën për regjistrim nëse gjendet në ranglistë deri në numrin e parashikuar për regjistrim në konkurs. Kandidati i cili e ka arritur të drejtën për regjistrim dhe në afatin e paraparë nuk e kryen regjistrimin e humb të drejtën e regjistrimit dhe në vend të tij të drejtën e regjistrimit e fiton kandidati

vijues nga ranglista.

Mes studentit dhe Universitetit lidhet Marrëveshje për studim me të cilën përcaktohen në detaje të drejtat dhe detyrimet reciproke.

#### IV. Dokumentet për aplikim dhe regjistrim

Aplikimi bëhet në shërbimin studentor të Universitetit.

Me aplikacionin kandidatët dorëzojnë:

- Fletëaplikim;
- Dokument origjinal për kryerjen e studimeve të ciklit të parë (diplomë ose certifikatë) (kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë shtetit të dorëzojnë edhe Vendimin e MASH për pranim të diplomës së huaj dhe ekuivalentim të notave);
- Biografi të shkurtër (CV);
- Dëshmi për njohje aktive të një gjuhe të huaj;
- Rekomandime të punonjësve arsimorë ose shkencorë (nëse i posedon të njëjtat);
- Listë të punimeve shkencore ose profesionale dhe një ekzemplar të të njëjtëve (nëse kandidati i posedon);
- Dokumente për shpërblime, mirënjohje dhe dokumente të tjerë.
- 800 denarë në llogarinë e Universitetit: në emër të shpenzimeve administrative.

Gjatë **regjistrimit**, kandidatët e pranuar duhet të dorëzojnë:

- Indeks dhe fletëparaqitje për regjistrim
- Dy fotografi (3,5x4,5)

Të gjithë kandidatët dokumentet e tyre për aplikim duhet t'i dorëzojnë në hapsirat e Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup në rrugën "Mirçe Acev nr. 4 /kati i 6-të (ZYRA 603), 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

#### V. Afatet për paraqitje dhe regjistrim

	Afati i parë	Brop porç*
Paraqitja e kandidatëve	12 shtator – 30 shtator 2022	16 janar – 3 shkurt 2022
Regjistrimi i kandidatëve	05 – 15 tetor 2022	08 – 14 shkurt 2022

\*Afati i dytë i regjistrimit do të realizohet për programet studimore për të cilat nuk janë plotësuar kuotat konkurruese dhe për të cilat ekzistojnë kushte për fillim dhe realizim të procesit mësimor në semestrin veror.

Pas përfundimit të afatit të parë të regjistrimit për vendet e lira në fakultete, gjegjësisht programet studimore, Universiteti do të publikojë numrin e vendeve të lira për regjistrim në afatin e dytë të regjistrimit në vitin akademik 2022/2023.

#### VËREJTJE:

- Kandidatët kanë mundësi përveç zgjedhjes së parë të programit studimor për të cilin konkurrojnë, të mund të zgjedhin edhe një program studimor, respektivisht të përcaktohen edhe për një program të dytë studimor nëse nuk arrijnë të jenë në listën e kandidatëve të pranuar në programin e parë studimor të zgjedhur.
- Informacionet e detajuara mbi kushtet e regjistrimit dhe studimit në secilin program studimor të publikuar, dokumentacionin e nevojshëm, organizimin dhe afatet kohore të studimeve, kandidatët e interesuar mund t'i marrin në shërbimin studentor të Universitetit.

Konkursi është i publikuar në uebfaqen:

<http://www.unt.edu.mk>